




REKLAIMI I PUNËS SË PËRZEMËRISË SË QEVERISË SË KOSOVËS		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT		AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DPK	Nr Prot.	03-02/4157/16
Dep.		Br Prot.	
Dep.		Prot No	
Nr. i faq		Data	
Broj stranica	02	Datum	03.11.2016
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.11.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-3381-16, për Zyrtarin e lartë z.Arbër Tolaj- Drejtor i Klinikës Ortopedike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-3381-16, për Zyrtarin e lartë, z. Arbër Tolaj-Drejtor i Klinikës Ortopedike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në bizneset private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Tolaj është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Tolaj është deklaruar se brenda afatit do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë ndryshimet në biznes (DPK/Dpki-03-02/4043/16) të bëra në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilat shihet se, z.Tolaj tashmë ka hequr dorë nga drejta e të qenurit person i autorizuar në biznes privat, duke emëruar një person të besuar në te, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.


II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



Shqip
/ Shqip Havolli /